

THIRRJE PËR DIZAJNIMIN E LOGOS DHE KRIJIMIN E “BRANDBOOK”-ut PËR LOJËRAT MESDHETARE PRISHTINA 2030

Komiteti Organizativ i Lojërave Mesdhetare (OCMG) “Prishtina 2030”, shpall thirrje publike për dizajnimin e logos dhe krijimin e “Brandbook” për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.

Çka duhet të përfshihet në brendim?

- Logo së bashku me udhëzuesin e përdorimit
- Adaptimi i logos në materiale promovuese dhe merchandising.
- Adaptimi i logos dhe brendit të LM Prishtina 2030 në objektet sportive (shembull i adaptimit - një objekt sportiv)
- Adaptimi i logos dhe brendit të LM Prishtina 2030 në objekte jo sportive (aeroporti ndërkombëtar “Adem Jashari”, qendra e akreditimit, qendra e mediave, qendra e mediave transmetuese, qendra e mjekësisë së LM, qendra e antidoping-ut, qendra e akomodimit të sportistëve dhe zyrtarëve, hotelet).
- Brendimi i mjeteve transportuese dhe stacioneve rrugore (autobusët, kombi-busët, veturat dhe biçikletat). Të prezantohen minimum tri adaptime.
- Brendimi i qytetit të Prishtinës dhe të qyteteve të tjera ku do të mbahen LM Prishtina 2030. Të prezantohet brendimi i Prishtinës dhe minimum dy rrugë.
- Adaptimi i brendimit në veshjet e stafit, vullnetarëve dhe kontraktorëve të LM Prishtina 2030.
- Çfarëdo brendimi tjetër i cili tregon kreativitetin e kompanisë konkurruese.

Kriteret e dizajnit të logos:

- Të jetë origjinale, unike dhe të mos jetë imitim i ndonjë logoje ekzistuese.
- Të ketë pasqyrim sportiv të veprimtarisë së Lojërave Mesdhetare;
- Të jetë kreative, cilësore, profesionale dhe prezantuese;
- Të jetë lehtësisht e kuptueshme;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- Të rezistojë kohës dhe të jetë e lehtë për t’u mbajtur në mend;
- Të jetë e përshtatshme për vendosje në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, e lehtë për shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta;
- Të jetë lehtë e përdorshme në madhësi të ndryshme (vertikale dhe horizontale);
- Logo duhet të përmbajë edhe rrathët e Lojërave Mesdhetare (ICMG);
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në logo.

Kush mund të konkurojë?

Të drejtë konkurimi kanë të gjitha kompanite e dizajnit grafik dhe marketingut digjital. Kompania duhet të kenë të paktën 5 vite përvojë në dhënie të shërbimeve të dizajnit.

Fituesi duhet të zhvillojë “brandbook” me të gjitha kërkesat shtesë sipas natyrës së ngjarjes shumësportëshe (multi-sportive) nga OCMG. Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi tek OCMG.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Komiteti Organizativ (OCMG) i LM Prishtina 2030 dhe vendimi final do të miratohet nga Bordi Ekzekutiv i ICMG.

Kriteret e vleresimit:

- Kreativiteti i konceptit të logos **45%**
- Implementimi i logos dhe identitetit vizual **30%**
- Oferta financiare **25%**

Propozimi duhet të dorëzohet përmes postës elektronike **application@noc-kosovo.org**, bashkë me një version vektor të logos.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit, afatet kohore të realizimit të projektit, si dhe ofertën financiare për logo dhe zhvillimin e versionit final të brandbook.

Data e fundit për aplikim: 25.03.2026 në ora 16:00 CET

** Për çdo informacion shtesë në lidhje me thirrje na shkruani në **application@noc-kosovo.org***